



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 14, datë 17.12.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:

“KOMPLEKS REZIDENCIAL DHE SHËRBIMI, 1-19 KATE ME 3 KATE NËNTOKË, (FAZA 1)”, “KOMPLEKS REZIDENCIAL DHE SHËRBIMI, 1-15 KATE ME 3 KATE NËNTOKË (FAZA 2)” DHE “KOMPLEKS REZIDENCIAL DHE SHËRBIMI, 1-30 KATE ME 3 KATE NËNTOKË (FAZA 3)”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “KASTRIOTËT”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, e ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Pajtoni” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks rezidencial dhe shërbimi, 1-19 kate me 3 kate nëntokë (Faza 1)”, “Kompleks rezidencial dhe shërbimi, 1-15 kate me 3 kate nëntokë (Faza 2)” dhe “Kompleks rezidencial dhe shërbimi, 1-30 kate me 3 kate nëntokë (Faza 3)”, me vendndodhje në Rrugën “Kastriotët”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Pajtoni” sh.p.k.
2. Hartat e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumentet e Rregullores së Veçantë për Fazat 1, 2 dhe 3, i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 31 /12/ 2025